

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për Promovimin dhe Përkrahjen e Turizmit në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 103/08, 156/10, 59/12, 187/13 , 41/14 dhe 83/18), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më dt. _____ e miratoi

PROGRAMIN PËR PROMOVIMIN DHE PËRKRAHJEN E TURIZMIT PËR VITIN 2023

Neni 1

Ky Program ka për qëllim promovimin dhe përkrahjen e turizmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2023.

Mjetet e nevojshme për realizimin e këtij programi janë paraparë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 dhe arrijnë 58.651.000,00 denarë, nga të cilat 14.159.000,00 denarë në llogarinë 637, 40.500.000,00 në llogarinë 631, 1.992.000,00 denarë në llogarinë 787, 2.000.000,00 në llogarinë 785 dhe ato janë planifikuar në Buxhet në Ndarjen 10003 - Agjencia për Promovimin dhe Përkrahjen e Turizmit, kategoria 42 - mallra dhe shërbime, 46 - subvencione dhe transferta dhe 48 - shpenzime kapitale.

Neni 2

Mjetet nga Neni 1 paragrafi 2 i këtij programi janë të destinuar për aktivitete promovuese, marketing dhe bashkëpunim ndërkombëtar dhe aktivitete për përkrahjen e turizmit, përkatësisht:

a) Për aktivitete promovuese, marketing dhe bashkëpunim ndërkombëtar janë dedikuar gjithsej 10.559.000,00 denarë, edhe atë për:

1. Pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare, rajonale dhe lokale të turizmit në Stamboll, Madrid, Berlin, Beograd, Tiranë e të tjera, si dhe pjesëmarrje dhe organizim i seminareve ndërkombëtare, rajonale, lokale dhe investuese dhe konferenca, samite dhe forume të tjera në fushën e turizmi jashtë vendit dhe në Republikën e Maqedonisë së

Veriut në përputhje me nevojat dhe kërkesat e industrisë së turizmit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut,

janë dedikuar 4.850.000,00 denarë.

2. Organizimin e fushatave promovuese që do të zhvillohen në vendet që janë treg primar, si: Serbia, Kroacia, Bullgaria, Shqipëri, Kosova, Polonia, Turqia, si dhe në vendet që janë treg sekondar, si: Sllovenia, Italia, Greqia, Spanja, por edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të tjera. Fushatat promovuese do të përfshijnë:

- Promovim elektronik,
- Promovim nëpërmjet blogerëve dhe
- Promovim përmes vlogerëve,

janë dedikuar 3.200.000,00 denarë.

3. Hosting, mbështetje dhe mirëmbajtje të portalit zyrtar turistik maqedonas, ueb faqes www.northmacedonia-timeless.com, si dhe mbështetje hosting dhe mirëmbajtje e ueb faqes www.tourismmacedonia.gov.mk,

janë dedikuar 150.000,00 denarë.

4. Organizim të udhëtimeve informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut për blogerë, vlogerë, influencers, operatorë turistikë, media, gazetarë dhe të tjerë, qëllimi i të cilave është njohja me potencialin turistik të vendit tonë dhe promovimi i destinacioneve turistike dhe produkteve për të arritur një nivel të caktuar të njohjes dhe konkurrencës së produktit turistik maqedonas,

janë dedikuar 300.000,00 denarë.

5. Shtypja e materialit promovues (broshura, doracakë, afishe, harta, kartëvizita dhe ngjashëm),

janë dedikuar 800.000,00 denarë.

6. Dizajn dhe përpilim i materialit të imët promovues (stilolapsa, filxhanë, USB, bexhe, fletore dhe të tjera) për qëllime promovuese turistike me qëllim të promovimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si destinacion turistik.

janë dedikuar 59.000,00 denarë.

7. Produksion, dizajnim dhe përpilim të një botimi elektronik të një broshure turistike me përgatitje për shtyp të një foto-broshure. Foto-broshura do të jetë një nga mjetet kryesore promovuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut në mediat sociale, gjegjësisht nën një hashtag specifik dhe karakteristik që do të jetë aktiv në “Instagram” duke përdorur hashtagun #SafeLikeHome, #домасиедома,#allinMacedonia, #domasiedoma, #askundsinështëpi. Fotografitë tematike do të prezantojnë perspektiva të ndryshme të vendit tonë, bukuritë natyrore, ngjarjet dhe manifestimet kulturore dhe tradicionale, njerëzit, historinë dhe gjithçka që i jep karakterin origjinal dhe të përhershëm Republikës së Maqedonisë së Veriut,

janë dedikuar 50.000,00 denarë.

8. Produksion, dizajnim dhe përpilim të botimeve elektronike të broshurave turistike me përgatitje për shtyp, si dhe produksion i video-materialit për:

- turizmin fetar (manastiret, kishat, xhamitë etj.) në Republikën e Maqedonisë së Veriut si destinacion turistik në përputhje me Strategjinë për Zhvillimin e Turizmit Fetar.
- turizëm ekologjik të qëndrueshëm *Travel like a local* në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- specialitete tradicionale që janë pjesë e rëndësishme e ofertës në rajone, me synim pasurimin e ofertës turistike dhe rritjen e promovimit të shtetit;

janë dedikuar 950.000,00 denarë.

9. Prodhimi i videove për zanatet dhe traditën e vjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si segment i industrive kreative që ndërlidhen me traditat, zakonet dhe matricën e identitetit të banorëve të vendit tonë, ruajtja dhe mirëmbajtja e të cilave ndikon edhe në pasurimin e ofertës turistike dhe segmentin që lidhet me turizmin kulturor,

janë dedikuar 200.000,00 denarë.

b) Për aktivitete për përkrahjen e turizmit janë dedikuar gjithsej 1.600.000,00 denarë, si:

1. Vazhdimi i projektit “Vendosja e shenjave informative turistike”. Ky projekt ka filluar në vitin 2022. Me shenja udhërrëfyese dhe turistike, të ashtuquajtura shenja kafe, do të shënjohen disa atraksione turistike në pjesën e autostradës së re Shkup - Shtip, si dhe në autostradën e re Shtip – Radovish deri në Strumicë, me qëllim të rritjes së informimit të udhëtarëve potencialë vendas dhe të huaj në këto drejtime rrugore,

janë dedikuar 700.000,00 denarë

2. Krijimi i një karte gastronomie me specialitete tradicionale, që janë pjesë e rëndësishme e ofertës në rajone, me synim pasurimin e ofertës turistike dhe rritjen e promovimit të shtetit.

janë dedikuar 300.000,00 denarë

3. Projekti “50 fshatra, 50 histori”, i dedikuar për zhvillim të integruar rural duke synuar fshatrat me potencial për agroturizëm, turizëm rural, zhvillim social-ekonomik dhe trashëgimi kulturore, me synim komponentin e zhvillimit të tyre, mundësinë promovuese dhe reduktimin e migrimit. Projekti është prej shumë vitesh dhe zhvillimor dhe këtë vit është i pari që parasheh një hulumtim në terren për mundësitë e turizmit rural, përzgjedhjen e 50 fshatrave dhe informimin e publikut dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vazhdimin e mëtejshëm të projektit me implikime financiare.

janë dedikuar 50.000,00 denarë

4. Projekti “Pesë marsh-rutat për Turizmin Fetar”, i cili rrjedh nga Strategjia Kombëtare për Turizmin Fetar dhe parashikon propozimin dhe krijimin e pesë marsh-rutave me karakter fetar dhe propozim për përdorimin e plotë të tyre për agjencitë turistike që punojnë me turizmin hyrës,

janë dedikuar 50.000,00 denarë.

5. Punëtori dhe trajnime për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e turizmit fetar, i cili rrjedh nga Strategjia Kombëtare për Turizmin Fetar dhe është planifikuar të mbahet një punëtori dhe trajnime me sektorin e turizmit dhe aktorë të tjerë të turizmit,

janë dedikuar 300.000,00 denarë.

6. Projekti “Mbrojtja e artizanaleve ekzistuese dhe restaurimi i zanateve të vjetra në funksion të turizmit”. Projekti parashikon inicimin e krijimit të një hapësire atraktive si Çarshi ku do të përqendrohen artizanët. Krijimi i kodeve QR dhe promovimi digjital i lokacionit turistik duke futur aplikacione softuerike për platformat digjitale,

janë dedikuar 50.000,00 denarë.

7. Ngritja e auto-kampeve dhe promovimi i tyre – rritja e ofertës turistike, zhvillimi i turizmit auto-kampues, promovimi i tyre dhe tërheqja e kapitalit të huaj dhe vendas për ngritjen e auto-kampeve.

janë dedikuar 50.000,00 denarë.

8. Formimi, zhvillimi, rrethimi dhe shënjimi i zonave të zhvillimit turistik,

janë dedikuar 50.000,00 denarë.

Neni 3

Për subvencionimin e qarkullimit të organizuar turistik të huaj janë dedikuar gjithsej 42.500.000,00 denarë, edhe atë: një pjesë nga llogaria 637 në vlerë prej 2.000.000,00 denarë, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve në vlerë prej 40.500.000,00 denarë janë siguruar nga llogaria 631.

Neni 4

Mjetet në lartësi prej 1.992.000,00 denarë nga llogaria 787 dedikohen për organizimin e prezantimeve dhe takimeve me operatorët turistikë të huaj dhe Ditët e turizmit maqedonas jashtë vendit, si dhe për realizimin e projekteve nga Bashkimi Evropian dhe projekte të tjera ndërkombëtare që i janë ndarë Agjencisë.

Neni 5

Mjetet në vlerë prej 2.000.000,00 denarë nga llogaria 785 dedikohen për realizimin e projektit “*ABOVE*”, i cili është fituar si grant nga Komponenti IPA 2 për bashkëpunim ndërkufitar me Republikën e Greqisë.

Neni 6

Për realizimin e këtij Programi do të kujdeset Agjencia për Promovimin dhe Përkrahjen e Turizmit.

Neni 7

Shpërndarjen e mjeteve nga ky Program, në përputhje me aktivitetet dhe projektet e përcaktuara nga ky program, Agjencia për Promovimin dhe Përkrahjen e Turizmit e kryen sipas kritereve për zhvillim të balancuar rajonal.

Neni 8

Agjencia për Promovimin dhe Përkrahjen e Turizmit do t'i dorëzojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut Raport për aktivitetet e realizuara, si dhe për rezultatet e arritura me arsyetim për devijime të mundshme nga aktivitetet e planifikuara, deri më 30 qershor 2024.

Neni 9

Ky program hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. _____

Kryetar i Qeverisë së
Republikë së Maqedonisë së Veriut
Dr. Dimitar Kovačevski

Dt. _____

Shkup

<p>Unë, Neat Duraku, përkthyes i autorizuar gjyqësor, me vulën dhe nënshkrimin tim vërtetoj se përkthimin në gjuhën shqipe e kam kryer në mënyrë identike si origjinali në gjuhën maqedonase.</p> <p>Shkup, dt. 21.02.2023</p>	<p>Јас, Неат Дураку, Овластен судски преведувач, со својот потпис и печат, потврдувам дека преводот на албански го извршив верно на оригиналот на Македонски јазик.</p> <p>Скопје, 21.2.2023 год.</p>
--	---